

VENDIM
Nr.117, datë 23.7.2007

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, TË NJË MJEDISI NË
PRONËSI TË RADIO TELEVISIONIT PUBLIK SHQIPTAR KËSHILLIT KOMBËTAR TË
RADIOS DHE TELEVISIONIT**

Në mbështetje të neneve 2 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 7, 64 dhe 147 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr.440, datë 1.6.2000 të Kuvendit "Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)" dhe të neneve 11 dhe 12 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, pas dhënies/marrjes së pëlqimit paraprak të Këshillit Drejtues të RTSH-së,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien në përdorim, pa kundërshtpërblim, të mjediseve të godinës në pronësi të Radio Televizionit Publik Shqiptar, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë për një afat të pacaktuar.

II. Në kontabilitetin e RTSH-së të pasqyrohet dhënia në përdorim, pa kundërshtpërblim, pa afat të caktuar, e mjediseve të përcaktuara në pikën I të këtij vendimi.

III. Shpenzimet që do të kryhen për rikonstruksionin e mjediseve të përcaktuara në pikën I të këtij vendimi, të përballohen në emër dhe për llogari të Buxhetit të Shtetit. Ato janë të pakompensueshme nga Radio Televizionit Publik Shqiptar.

IV. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Publik Shqiptar dhe Kryetari i Këshilli Kombëtar të Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

